



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 11 - 2009
Prishtinë, më 06 prill 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Bajram Kosumi, Kolë Berisha, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj dhe Adem Hajdaraj.

Munguan: Branislav Grbiq dhe Selvije Halimi.

Të pranishëm: Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti, Reshit Gashi – KDI, Lejla Selimi - OSBE, Lumnije Murati – ZPRK dhe Vlora Marmullaku.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 27 marsit 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – I përshëndeti të gjithë të pranishmit. I falënderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit dhe i njoftoi për rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 27 marsit 2009

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua me vërejtjen e z. Armend Zemaj, i cili kërkoi që diskutimi i tij të ndahet në dy pjesë.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore

Kryetari - Shtoi se do ta amendamentojmë Projektligjin për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore. Gjithashtu i njoftoi se së shpejti do ta kemi edhe Projektligjin për sekuestrimin e pasurisë, në të cilin Komisioni do t'i japë propozimet preliminare. Më tutje përmendi edhe takimin me ekspertët, të datës 23. 03. 2009. Për ta nuk kishte asgjë të paqartë përveç buxhetit, që njëherësh ka qenë shqetësim edhe i Komisionit. Me këtë çështje do të merret Komisioni për Buxhet dhe Financa.

I pyeti anëtarët e Komisionit a duan të lexohet Projektligji nen për nen, apo vetëm aty ku ka vërejtje?

Armend Zemaj - Theksoi se është i mendimit të shkohet nen për nen, meqenëse Projektligji nuk është voluminoz. Me mendimin e tij u pajtuan edhe anëtarët e tjerë të Komisionit.

Ibrahim Makolli - Propozoi të merren parasysh edhe amendamentet e deputetit Riza Smaka, që i paraqiti me shkrim për emërtimin e Projektligjit: Ligji për Departamentin e Mjekësisë Ligjore.

Komisioni e miratoi propozimin e deputetit Riza Smaka dhe u vendos që nga titulli i Projektligjit të hiqet fjala *themelimin*.

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje për preambulën e këtij projektligji. Për qëllimin e Ligjit pati diskutime të shumta lidhur me shprehjen: *si pasojë e konfliktit*, ë mund të ndryshohet e të bëhet: *si pasojë e luftës*.

Adem Salihaj - Lidhur me nenin 1: Qëllim i Ligjit për Departamentin e Mjekësisë Ligjore nuk duhet të lidhet me një periudhë të caktuar. Shtoi se nuk duhet të jetë konflikt, sepse kjo ndërlihet me një periudhë të caktuar. Propozoi të hiqet nga teksti i Projektligjit

fjalja në rreshtin e gjashtë: “Mbetjeve mortore të shkaktuara si pasojë e konfliktit në Kosovë”.

Pati diskutime të shumta edhe rreth përdorimit të fjalës *ekshumim* (zhvarrosje), por mbizotëroi mendimi se termi *ekshumim* është më i përshtatshëm.

Adem Hajdaraj - Te përkufizimet, në nenin 2, pati vërejtje se në të shumtën e rasteve është përdorur fjala *nënkupton* edhe aty ku nuk e kishte vendin, p.sh.: mjekësia ligjore *nënkupton* në këtë rast do të duhej të përdorej: *fjala është*.

Adem Salihaj - Propozoi që te përkufizimi *toksikologjia*, në rreshtin e parë, fjala *nënkupton*, të zëvendësohet me fjalën *paraqet*, ndërsa fjala *kundër efekteve* do të duhej të shkruhej së bashku: *kundërefekteve* - jo ndaras, sikurse në tekstin e Projektligjit, sepse po e humb kuptimin. Po ashtu në vend të fjalës *nënkupton*, duhet të përdoret fjala *paraqet*.

Ibrahim Makolli - Pati vërejtje te përkufizimi *autopsia*, në rreshtin e shtatë. Propozoi të hiqet fjalia: “Një autopsi mund të kryhet ose me urdhrin e gjykatës, me pëlqimin e të afërmit, ose nga interesi publik”. Po ashtu propozoi që edhe te përkufizimi *Hetues mjekësor për raste të vdekjeve* të hiqet fjalia në rreshtin shtatë: “E papritur shkaktuar me dhunë dhe nga pakujdesia”.

Ibrahim Makolli - Pati vërejtje edhe për rreshtin e parë të fjalisë te përkufizimi “Me persona të zhdukur”. Propozoi të riformulohet si vijon: *Personat e zhdukur*. Për emërtimin e kësaj kategorie pati diskutime a duhet të quhen *persona të zhdukur* apo *të humbur*, kurse familjarët këtë kategori e quajnë *persona të pagjetur*, ndërsa ndërkombëtarisht përdoret *persona të zhdukur*. Nuk është mirë të kufizohet koha për persona të zhdukur, sepse ata mund të jenë zhdukur para, gjatë dhe pas luftës. Gjithashtu propozoi të hiqet fjalia në rreshtin e gjashtë: “Si pasojë e konfliktit në Kosovë”.

Kryetari - Theksoi se te përkufizimet nuk kemi të bëjmë me dispozita të ligjit, por më tepër me sqarime dhe se amendamentet te përkufizimet do të përfshihen në një amendament të vetëm.

Bajram Kosumi - Pyeti si është rregulluar te qëllimi i Ligjit, nëse atje janë hequr fjalët: *si pasojë e konfliktit në Kosovë*. Kjo është në rregull, por duhet të kihet parasysh se ky departament po krijohet për personat e zhdukur gjatë luftës. Në diskutimin e herës së dytë e shtroi edhe çështjen e laboratorit të ADN-së. *A është përfshirë ky në tekstin e këtij projektligji?*

Dzezair Murati - Tha se terminologjia në gjuhën serbokroate është shumë e qartë, sepse njerëzit nuk janë zhdukur vetëm gjatë luftës ose konfliktit, por edhe para, gjatë dhe pas konfliktit ose luftës.

Ibrahim Makolli - Themelimi i Departamentit të Mjekësisë Ligjore nuk ka për qëllim vetëm *ekshumimin* e personave të zhdukur, sepse po krijohet edhe për të gjithë personat e

zhdukur, që nuk kanë të bëjnë me kohën e luftës. Për persona të zhdukur do të nxirret një ligj i veçantë. Nëse nuk përdoret termi luftë, të mos përdoret as termi konflikt.

Kryetari – Theksoi se nëse i përdorim fjalët *personat e zhdukur si pasojë e luftës në Kosovë* jam shumë i sigurt se ky projektligj nuk do të shkojë tutje dhe do të mbesim pa të. Për qëllimin e Ligjit do të diskutojmë edhe një herë në Komision dhe do të merret parasysh edhe mendimi i ekspertëve, sepse është çështje shumë e ndjeshme.

Armend Zemaj - Pati vërejtje për nenin 6 të Projektligjit, në të cilin thuhet se personeli do të zgjidhet dhe do të shkarkohet në pajtim me Ligjin për shërbyesit civilë. Nuk e di sa ka nevojë të mbetet kështu, kur dihet si zgjidhen dhe ky nen nuk ka nevojë të jetë fare në tekstin e Projektligjit.

Kryetari – Vuri në pah se me ligjin e ri do të jenë dy kategori: shërbyes civilë dhe administratë publike. Numri i shërbyesve civilë do të jetë më i vogël në krahasim me numrin e tanishëm.

Ibrahim Makolli - Propozoi që te neni 8.2, në rreshtin e tetë, të hiqet fjala *njohur* dhe fjala *ndërkombëtarisht* dhe të riformulohet në *ndërkombëtare*.

Bajram Kosumi - Pati vërejtje edhe për nenin 8.2.1 për angazhimin e ekspertëve vendorë dhe të atyre të EULEX-it. Sipas këtij neni del se ekspertët kryesisht janë të EULEX-it dhe mund të mos merren fare ekspertë vendorë. Në tekstin e Projektligjit thuhet: *kur është e mundshme*. Kjo krijon mundësi të përjashtohet eksperti vendor.

Anëtarët e Komisionit patën vërejtje edhe për nenin 9 për shfuqizimin, që duhet të riformulohet ndryshe, sepse nuk është përdorur mirë, pasi ky term duhet të mbetet: *Ky ligj shfuqizon të gjitha dispozitat ligjore, që janë në kundërshtim me të*. Neni 10 po ashtu duhet të riformulohet.

Komisioni nuk e përkrahu as amendamentin e dytë të propozuar nga deputeti Riza Smaka, i cili kishte të bënte me miratimin e akteve nënligjore të Ministrisë së Drejtësisë. Anëtarët e komisionit vunë në pah se Ministria nuk i miraton aktet nënligjore, por i nxjerr ato.

Hartoi stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni